

FJALA E DEPUTETIT FATMIR MEDIU

E ENJTE 22 SHTATOR 2022

E nderuar, zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë mendoj se ky Kuvend ka shumë çështje, për të cilat mund të bëjmë debate pa fund, madje ndonjëherë mund të bëjmë edhe teatër, por, ajo që është më e rëndësishme, për çështje të sigurisë kombëtare duhet të jemi seriozë me veten tonë, me qytetarët dhe me vendin tonë. Ne jemi në sulm nga Irani, një vend shumë i fuqishëm, ndaj asnjëherë nuk duhet ta neglizhojmë. Qëndrimin ndaj Iranit e kemi pasur të përbashkët, që në kohën e qeverisë “Berisha”, e cila pranoi të strehonim “rezistencën iraniane” në Shqipëri.

Pa dyshim, ne mbajtëm qëndrim tërësisht kundër shtetit të Iranit në atë kohë, në shërbim të mbrojtjes së interesave dhe lirive e të drejtave të një grupi që persekutohej nga regjimi iranian. “Rezistenca iraniane” ishte rezistenca më e organizuar politike. I njëjti qëndrim vazhdoi edhe me qeverinë “Rama”, pra kemi qenë të gjithë në të njëjtën marrëdhënie. Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike me Iranin nuk besoj se na ndan politikisht, sepse kemi pasur të njëjtin qëndrim, por nëse kemi besuar se mund të mbajmë këto qëndrime politike dhe pjesa tjetër do të rrijë indiferente karshi nesh, mendoj se kemi bërë një gabim ose jemi naivë me veten tonë.

Irani ka kryer dhe do të vazhdojë të kryejë sulme kibernetike, jo vetëm Irani, por edhe aleatë të tjerë, të cilët nuk duan që Shqipëria dhe Ballkani të jenë pjesë e Bashkimit European dhe NATO-s. Shtetet autoritare kanë ndërtuar tashmë një aleancë të qartë, e treguar qartësisht edhe para një jave: marrëdhënien ndërmjet Rusisë, Kinës dhe Iranit, për të ndërtuar një rregull të ri botëror, e cila duhet të na bëjë të fillojmë të gjykojmë dhe të mendojmë siç duhet, si parlamentarë, ku interesi primar të jetë ai kombëtar. Ky moment që po kalojmë duhet të na bëjë të reflektojmë. Në radhë të parë, duhet ta bëjë qeverinë të reflektojë, jo duke e parë si një

moment triumfalizmi, por si një moment përgjegjësie, si dhe të gjithëve ne, për të parë se çfarë mund të kontribuojmë në sigurinë tonë kombëtare, për të mos e kthyer në një debat të pavlefshëm dhe të pafrytshëm.

Ne (një grup deputetësh, pozitë dhe opozitë) sa u kthjem nga një vizitë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kemi pasur një qëndrim të përbashkët, duke dënuar sulmin, duke vlerësuar mbështetjen që vjen nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe kemi kërkuar njëzëri, pa asnjë lloj dallimi, që Shqipëria të mbështetet jo vetëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe nga NATO me asistencë teknike dhe asistencë të tjera, në mënyrë që të dimë se ku i kemi problemet dhe si t'i tejkalojmë ato. Më lejoni t'i adresohem qeverisë: është momenti që ta marrim seriozisht këtë situatë, sepse nuk jemi të imunizuar. Në çështje kibernetike, no trust. Është e padiskutueshme, nuk ka asnjë sistem perfekt.

Ndaj duhet të përpiqemi të bëjmë atë që është më e mira. Me vende të tilla partnere si Shtetet e Bashkuara të Amerikës ne mund të arrijmë në nivelin më të mirë të mbrojtjes kibernetike. Kjo kërkon një bindje nga të gjithë ne, që nuk janë financa të shpenzuara kot. Mbrojtja kibernetike ndryshon shumë nga të gjitha zhvillimet që kemi bërë ne për sistemet online, sistemet IT-së e të tjera me radhë, të paktën në mënyrë amatore, siç tha edhe kolegu im, me dijen që kam rreth kësaj çështjeje. Në radhë të parë, duhet të bëjmë një vlerësim të plotë të të gjitha sistemeve tona, të bëjmë një server assessment e të gjejmë se ku i kemi problemet, sidomos në infrastrukturën kritike, sepse mund të jenë ato sulmi i radhës, i cili kostot jo vetëm financiare, por edhe të sigurisë kombëtare i ka akoma më të mëdha, pastaj të ndërtojmë një skemë të vlerësimit, parandalimit dhe, pa dyshim, të mbrojtjes kibernetike.

Të nderuar kolegë,

Ne duhet patjetër të bashkohemi për të gjetur këto zgjidhje. Çështja e sigurisë kombëtare nuk është vetëm një çështje e qeverisë dhe ky është një nga gabimet që kemi në funksionimin e shtetit tonë. Ne kemi një Këshill të Sigurisë Kombëtare pothuajse tërësisht inefficent. Ndaj duhet të mendojmë se ndoshta ka ardhur koha ta ndryshojmë marrëdhënien me sigurinë kombëtare, jo vetëm për faktin se jemi nën sulme kibernetike nga Irani, por sepse sot qartësisht

ka një konflikt të hapur dhe një botë, e cila po ndahet, dhe interesat për të zhvilluar konflikte në Ballkan, që bien ndesh me interesin tonë kombëtar, janë evidente.

Mendoj se ka ardhur koha që të ndërtohet një agjenci e sigurisë tonë kombëtare, e cila të merret në mënyrë të përditshme me analizën e problemeve të sigurisë, të koordinimit të të gjitha institucioneve të inteligjencës, institucioneve të sigurisë, por siguria i tejkalon edhe ato që në dukje i kemi si institucione sigurie, duke përfshirë edhe elemente të tjera të fushave të ekonomisë, edhe të Kuvendit të Shqipërisë, në një marrëdhënie të përbashkët, në mënyrë që të dimë të analizojë, të ndërtojmë partneritet dhe ta kemi të garantuar mbrojtjen tonë. Ne jemi vend anëtar i NATO-s, ndaj duhet ta marrim seriozisht anëtarësimin tonë, jo vetëm duke parë se çfarë mbrojtjeje na ofron NATO, por edhe duke parë se çfarë partneriteti i ofrojmë ne NATO-s, si vend anëtar i saj.

Politikisht ne kemi bërë mjaftueshëm, por nga pikëpamja e niveleve operacionale duhet të vijmë në një standard tjetër, në radhë të parë, duhet të shikojmë se si të mbrohemi vetë, pastaj, në bazë të artikullit V, të shikojmë si do të na mbrojë NATO. Prandaj investimet në Forcat e Armatosura, në forcat e inteligjencës dhe në sigurinë kibernetike janë një domosdoshmëri sot. Nuk jetojmë më në ëndrrat e paqes së madhe apo të mbrojtjes që na vjen gjithandej, pa e ditur se si të sillemi dhe si të mbrojmë njëri-tjetrin.

Ndaj, të nderuar kolegë deputetë, këtë debat që po bëhet këtu, ndoshta do të ishte më mirë që qeveria ta bënte më transparent, duke i informuar deputetët për të gjithë situatën, në mënyrë që të kemi qartësinë e asaj çfarë po ndodh dhe, për më tepër, të asaj çfarë duhet të bëjmë të gjithë së bashku, sepse Shqipëria dhe siguria kombëtare janë mbi gjithsecilin nga ne.